



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 27.06.2023)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Ristrukturimit (relatore znj. Marçela Shehu).

1.1 “Për transferimin e përhershëm të Kancelarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë”;

1.2 “Për transferimin e përhershëm të Kancelarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:57 dhe mbaroi në orën 13:32.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)

8. *Alban Toro* (anëtar)  
9. *Marçela Shehu* (anëtare)  
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)  
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *Klodiana Vogli dhe Sarmela Titka, Përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
6. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI).*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
8. *BIRN.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Ristrukturimit (relatore znj. Marçela Shehu).
  - 1.1 “Për transferimin e përhershëm të Kancelarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë”;
  - 1.2 “Për transferimin e përhershëm të Kancelarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë”.

*Naureda Llagami:* Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 27 qershor.

Siç jeni në dijeni, në mbledhjen e sotshme aktet më të rëndësishme janë lidhur me zbatimin e fazës së tretë të hartës së re gjyqësore që kanë të bëjnë me gjykatat e shkallës

së parë administrative, konkretisht Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë dhe në Gjykatën Administrative Tiranë.

Pa humbur kohë po ia jap fjalën fillimisht zonjës Shehu dhe më tej zotit Rusi.

**Marçela Shehu:** Faleminderit Kryetare!

Në zbatim të vendimit nr. 304, datë 05.06.2023 “Për Krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe Vlorë”, Komisioni i Ristrukturimit në funksionalitet të tij, zhvilloi mbledhjet përkatësisht më datë 08.06.2023, sipas përbërjes respektive, pranë ambienteve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në mbështetje të vendimit nr.557, datë 29.12.2022 të KLGJ-së “Për krijimin, kompetencat dhe funksionimin e Komisioneve të Ristrukturimit”, ndryshuar me vendimin nr. 285, datë 29.05.2023, në të cilat u diskutua mundësia e sistemimit të kancelarëve, nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë, në kuadër të riorganizimit të rretheve gjyqësore.

Në mbledhjen e datës 07.06.2023 Komisioni i Ristrukturimit, në zbatim të akteve ligjore në fuqi, kritereve të përgjithshme dhe të veçanta, në përputhshmëri me pozicionet vakante të kancelarit, por, edhe pozicioneve vakante të trajtuara me dispozita të ligjit për shërbimin civil, në gjykatat e shkallës së parë, vendosi të propozojë sistemimin e kancelarëve pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, si më poshtë:

- Znj. {...}, nga pozicioni Kancelar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, në pozicionin Kancelar, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë – mbështetur edhe në faktin e vakancës së pozicionit vakant Kancelar pranë kësaj gjykate, si dhe në kriteret përkatëse;

- Znj. {...} nga pozicioni Kancelar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë në pozicionin a) Shef Sektori, në Sektorin e Koordinimit të Zyrave të Shërbimit dhe Protokoll/Arkivë, b) Shef Sektori, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

Sa më sipër, në mënyrë unanime, Komisioni i Ristrukturimit, pas propozimeve të Zv.Kryetarëve të gjykatave respektive dhe shprehjes së opinionit personal të

kancelarëve, me vendimin nr. {...} prot., datë 08.06.2023, miratoi propozimet e transferimit të përhershëm të kancelarëve në detyrë.

Komisionet e Ristrukturimit, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore, duke ushtruar funksionalitetin e tyre, kanë përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendimet respektive, si dhe nga ana e strukturave funksionale pranë KLGJ-së është kryer njoftimi i Kancelarëve lidhur me propozimet konkrete për sistemim.

Kancelarët në detyrë, brenda afateve ligjore, kanë shprehur në rrugë elektronike, por edhe me shkresë mendimin e tyre, më konkretisht:

- Znj. {...}, ka shprehur refuzimin për pozicionin e propozuar si Kancelar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë;

- Znj. {...}, ka shprehur gjithashtu refuzimin e saj për dy pozicionet e propozuara si Shef Sektori pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

Kjo është situata dhe ajo çfarë ka ndodhur në Komisionin e Ristrukturimit.

Më poshtë në relacion keni të detajuar informacionin mbi të dhënat personale për kancelarët si dhe një informacion mbi vendet/pozicionet vakante sot në sistemin gjyqësor.

Bazuar në sa më sipër duke konsideruar refuzimin e zonjës {...} për të ushtruar funksionin e kancelares pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, propozohet që zonjë {...} të ruajë statusin e Kancelarit në detyrë dhe të transferohet në mënyrë të përhershme në një pozicion në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe konkretisht në pozicionin Shef Sektori, pranë Sektorit të Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun. Ndërsa pozicioni i kancelares tashmë t'i takojë zonjës {...}, pra Kancelares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, e cila të transferohet si Kancelare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë. Zonja {...} ka shprehur dakordësinë/pëlqimin për të ushtruar këtë funksion. Këto janë dy propozimet dhe dy projektvendimet e paraqitura për miratim.

Nëse ka ndonjë diskutim.

Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Atëherë, ka ndonjë diskutim nga kolegët?

Faleminderit zonja Shehu!

(Nuk ka diskutime.)

Jo!

Atëherë, hedhim në votim projekt-aktin sipas propozimit të ardhur nga relatorja.

Projekt-akti i parë është për zonjën {...} e cila ruan statusin e Kancelarit në detyrë dhe transferohet në mënyrë të përhershme në pozicionin Shef Sektori, IT, Statistika dhe Marrëdhëniet me Publikun, në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Tiranë. Jemi dakord?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë miratohet projekt-akti.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek projekt-akti i dytë që ka të bëjë me znj. {...} që transferohet Kancelare në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Lushnjë. Efektet e vendimit fillojmë më datë 01.07.2023. Jemi dakord?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Miratohet projekt-akti.

\* \* \*

(Pika 1 të rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 27.06.2023)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Ristrukturimit (relator z. Ilir Rusi):

2.1 “Për transferimin e përhershëm të Kancelarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës”;

2.2 “Për transferimin e përhershëm të Kancelarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:57 dhe mbaroi në orën 13:32.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)

8. *Alban Toro* (anëtar)  
9. *Marçela Shehu* (anëtare)  
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)  
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *Klodiana Vogli dhe Sarmela Titka, Përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
6. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI).*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
8. *BIRN.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Ristrukturimit (relator z. Ilir Rusi):
  - 2.1 “Për transferimin e përhershëm të Kancelarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës”;
  - 2.2 “Për transferimin e përhershëm të Kancelarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë”.

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek dy projekt-aktet e radhës, për të cilat fjalën ia jap zotit Rusi.

*Ilir Rusi:* Faleminderit Kryetare!



Në zbatim të vendimit nr. 303, datë 05.06.2023 “Për Krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Shkodër”, Komisioni i Ristrukturimit zhvilloi mbledhjen e parë më datë 07.06.2023, në të cilën u diskutua mundësia e sistemimit të kancelarëve, në kuadër të riorganizimit të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë.

Në mbledhjen e datës 07.06.2023, Komisionit i Ristrukturimit të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Shkodër në zbatim të akteve ligjore në fuqi, mori në shqyrtim dhe vlerësoi sistemimin e Kancelarëve të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe Korçë.

Referuar vendimit nr. 193, datë 26.04.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendimit nr. 194, vendimit nr. 195, dhe vendimit nr. 197, për transferimin e përhershëm të kancelarëve, shkresës nr. {...} prot., datë 15.02.2023, përcjellë anëtarëve të KLGJ me anë të postës elektronike në datë 11.04.2023, si dhe referuar vakancave të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, sipas propozimeve të Zv.Kryetarëve të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe Korçë, dhe shprehjes së opinionit të kancelarëve, u propozua si më poshtë:

Transferimi i përhershëm i znj. {...}, nga pozicioni Kancelar, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, në pozicionin Shef Sektori, në Sektorin e Koordinimit të Zyrave të Shërbimit dhe Protokoll/Arkivë, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Transferimi i përhershëm i z. {...}, nga pozicioni Kancelar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, në pozicionin Shef Sektori, në Sektorin e IT, Statistikës dhe Marrëdhënieve me Publikun, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Me vendimin nr. {...} prot., datë 07.06.2023, Komisioni i Ristrukturimit të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Shkodër, vendosi t'i propozojë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

Për Gjykatën e Administrative të Shkallës së Parë Durrës:

- Transferimin e përhershëm të znj. {...}, nga pozicioni Kancelar, pranë

Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, në pozicionin Shef Sektori, në Sektorin e Koordinimit të Zyrave të Shërbimit dhe Protokoll/Arkivë, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Për Gjykatën e Administrative të Shkallës së Parë Korçë:

- Transferimin e përhershëm të z. {...}, nga pozicioni Kancelar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, në pozicionin Shef Sektori, në Sektorin e IT, Statistikës dhe Marrëdhënieve me Publikun, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Me shkresën nr. {...}, datë 08.06.2023, Kryetari i Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Shkodër, i ka dërguar Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendimin propozues nr. {...} prot., datë 07.06.2023.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, nëpërmjet shkresave dhe postës elektronike, i ka përcjellë vendimin propozues të Komisionit të Ristrukturimit, Kancelarëve të mësipërm.

Me shkresën nr. {...} prot., datë 08.06.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe nëpërmjet postës elektronike, në datë 08.06.2023, Kancelarja e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës znj. {...}, është njoftuar mbi vendimin propozues të Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Shkodër, nr. {...}, datë 07.06.2023, duke i kërkuar që brenda një afati 5-ditor të shprehet me shkrim për pranimin ose refuzimin e vendimit propozues, për transferimin e përhershëm në pozicionin e propozuar për sistemin.

Me anë postës elektronike, në datë 12.06.2023 dhe shkresës nr. {...} prot., datë 12.06.2023, protokolluar në Këshill me nr. {...} prot., datë 14.06.2023, Kancelarja e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës znj. {...}, ka përcjellë mendimin me shkrim mbi vendimin nr. {...} prot., datë 07.06.2023, të Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Shkodër, për transferimin e përhershëm të saj në pozicionin Shef Sektori, në Sektorin e Koordinimit të Zyrave të Shërbimit dhe Protokoll/Arkivë, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndër të tjera duke parashtruar si më poshtë:

“...kërkoj nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor të marrë në konsideratë mundësinë e transferimit në pozicionin e Kancelarit pranë Gjykatës së Lartë Tiranë, në

rast hapje procedure konkurrimi, si dhe mundësinë e transferimit në pozicionin e Kancelarit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në rast të hapjes së vendit vakant.

Në rast të moskrijimit të mundësive në njërin prej këtyre pozicioneve, shpreh mendimin për pranimin e pozicionit të propozuar në bazë të vendimit nr. {...} prot., datë 07.06.2023 të Komisionit të Ristrukturimit duke ruajtur statusin e kancelares në detyrë.

Me shkresën nr. {...} prot., datë 08.06.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe nëpërmjet postës elektronike, në datë 08.06.2023, Kancelari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë z. {...}, është njoftuar mbi vendimin propozues të Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Shkodër, nr. {...}, datë 07.06.2023, duke i kërkuar që brenda një afati 5-ditor të shprehet me shkrim për pranimin ose refuzimin e vendimit propozues, për transferimin e përhershëm në pozicionin e propozuar për sistemin.

Me anë të postës elektronike në datë 12.06.2023, dhe të shkresës nr. {...} prot., datë 12.06.2023, protokolluar në Këshill me nr. {...} prot., datë 14.06.2023, Kancelari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, z. {...}, ka përcjellë mendimin me shkrim mbi vendimin nr. {...} prot., datë 07.06.2023, të Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Shkodër për transferimin e përhershëm të tij në pozicionin Shef Sektori, në Sektorin e IT, Statistikës dhe Marrëdhënieve me Publikun, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, duke parashtruar si më poshtë:

“Nga ana ime, ju përcjell mendimin me shkrim për pranimin e pozicionit të propozuar nga Komisioni i Ristrukturimit”.

Përfundimisht, i propozohet Këshillit sipas edhe shprehjeve të opinionit të Kancelarëve aktual të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë dhe Durrës, transferimin konkretisht të zotit {...} si Shef Sektori, Statistikës dhe Marrëdhënieve me Publikun, pranë Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë dhe zonja {...}, aktualisht Kancelare në detyrë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, si Shefe Sektori, Statistikat dhe Marrëdhëniet me Publikun pranë Gjykatës

Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; duke filluar efektet financiare më datë 01.07.2023.

**Naureda Llagami:** Faleminderit zoti Rusi!

Atëherë, hedhim në votim projekt-aktin e parë, nëse nuk kemi diskutime, për zonjën {...} e cila ruan statusin e kancelarit në detyrë dhe transferohet në mënyrë të përhershme në pozicionin Shef Sektori në Sektorin e Koordinimit të Zyrave të Shërbimit dhe Protokoll Arkivë, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Jemi dakord?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Miratohet projekt-akti.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek propozimi i dytë i ardhur që ka të bëjë me Kancelarin zotin {...}, i cili ruan statusin e kancelarit në detyrë dhe transferohet në mënyrë të përhershme në pozicionin Shef Sektori në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, Statistika dhe Marrëdhëniet me Publikun, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Jeni dakord me projekt-aktin?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord. (*Vota e zotit Toro nuk dëgjohet në audio, por i kontaktuar nëpërmjet e-mailit ka konfirmuar (citoj): “Votimi im ka qenë në favor të draftit të paraqitur nga Relatori. Përfundimisht OK”. Për efekt të procesverbalit e-maili i konfirmimit të votës i bashkëlidhet procesverbalit të siglosur.*)

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Miratohet edhe ky projekt-akt.

\* \* \*

(Pika 2 të rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 27.06.2023)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rregullave për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:57 dhe mbaroi në orën 13:32.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

*1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

*2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashë.*

*3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

*4. Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*

*5. Klodiana Vogli dhe Sarmela Titka, Përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*

*6. Valbona Bala, Eksperte (EWMI).*

*7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

*8. BIRN.*

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rregullave për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen tjetër të radhës të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me miratimin e rregullave për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë. Për më shumë detaje fjalën ia jap zotit Kurushi.

*Klodian Kurushi:* Faleminderit zonja Kryetare!

Kemi paraqitur sot projektvendimin për miratimin e rregullave për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, bashkëlidhur projektregulloren. Unë pa humbur kohë po vijoj me parashtrimin e relacionit përkatës.

Kjo projektregullore e propozuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës u hartua në mbështetje të: i) ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”; ii) nenit 26, pika 1 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në

Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar); iii) nenit 51, pika 9 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar), ku parashikohet se: “Këshilli miraton rregulla të detajuara për procedurat e mbledhjes së përgjithshme, votimin, mënyrën e numërimit të rezultatit të votimit.”

Sa më lart, në hartimin e kësaj Rregulloreje u morën parasysh praktikat më të mira, huazuar nga Rregullorja e zgjedhjes së zëvendëskryetarëve të gjykatave të hartuar nga Këshilli dhe rregullorja për emërimin në Gjykatën Kushtetuese të propozimeve që KED-ja bën në Gjykatën e Lartë, pra një rregullore që është miratuar nga Gjykata e Lartë.

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurat e mbledhjes së përgjithshme, votimin si dhe mënyrën e numërimit të rezultatit të votimit për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

Ju bëj me dije se pika dy e projektregullores është shkruar “Rregullore për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”. E korrigjoj. Nuk është kjo rregullore. Po e them, është një gabim i yni, një lapsus. Por i referohemi rregullores që ka miratuar Gjykata e Lartë për votimin e propozimeve që KED-ja sjell në Gjykatën e Lartë për emërimin e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese.

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurat e mbledhjes së përgjithshme, votimin si dhe mënyrën e numërimit të rezultatit të votimit për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

Pas draftimit të kësaj rregulloreje është marrë edhe opinioni i Gjykatës së Lartë. Në komunikimin elektronik datë 15.06.2023 të përcjellë nga zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë është shprehur se: “Në emër të Gjykatës së Lartë, ju bëj me dije se projektregullorja e përgatitur nga ana juaj është studiuar nga të gjithë gjyqtarët. Përgjatimisht disa sugjerimeve që ka dhënë gjyqtar {...}, për të cilat askush nga gjyqtarët nuk ka vlerësuar të bëjë ndonjë koment, sepse KLGJ e ka miratuar një vendim për zgjedhjen e zëvendëskryetarit. E konsiderojmë të plotë projektin e përgatitur, me qëllim që ju të vijoni me procedurën e miratimit në Mbledhjen Plenare të KLGJ.”

Kjo Rregullore përbëhet nga 4 Krerë, prej 22 nene dhe 2 Aneke, siç do të sqarohen në vijim.

Përmbajtja e rregullores



Kreu I, i cili përmban dispozita të përgjithshme është i organizuar në 3 nene.

Në nenin 1, i cili përkufizohet “Objekti i Rregullores”, parashikohet se ky vendim përcakton rregulla të hollësishme për procedurat e mbledhjes së përgjithshme, votimin si dhe mënyrën e numërimit të rezultatit të votimit për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

Në nenin 2, përcaktohet baza ligjore për miratimin e kësaj rregullore, konkretisht bazuar në nenin 51, pika 9 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në nenin 3, të titulluar “Zgjedhja e Kryetarit të Gjykatës së Lartë”, është hartuar bazuar në Nenin 51/2 të Ligjit “Për Statusin”. Në këtë nen parashikohet se: 1. Kryetari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë nëpërmjet procesit të votimit, për një periudhë trevjeçare pa të drejtë rizgjedhjeje. 2. Kryetar i Gjykatës së Lartë zgjidhet gjyqtari i cili ka të paktën tre vjet përvojë profesionale si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nuk ka asnjë masë disiplinore në fuqi si dhe duhet të jetë vlerësuar të paktën “shumë mirë” në dy vlerësimet e fundit etike dhe profesionale. Gjyqtarët e emëruar nga radhët e kandidatëve jogjyqtarë në Gjykatën e Lartë, duhet të jenë vlerësuar të paktën “shumë mirë” në vlerësimin e mëparshëm etik dhe profesional.

Në Kreun II janë parashikuar dispozitat lidhur me thirrjen e Mbledhjes së Përgjithshme dhe procedura për funksionimin e saj.

Konkretisht në nenin 4, lidhur me drejtimin e Mbledhjes së Përgjithshme parashikohet se Mbledhja e Përgjithshme thirret dhe kryesohet nga Kryetari i Gjykatës së Lartë. Në mungesë të Kryetarit të Gjykatës së Lartë për shkak të mbarimit të parakohshëm të mandatit të tij, Mbledhja e Përgjithshme thirret dhe kryesohet nga Zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë.

Në nenin 5 parashikohet mënyra dhe afati për të shpallur ftesën për kandidaturat për Kryetarin e Gjykatës së Lartë. Më konkretisht, Kryetari ose zëvendëskryetari, fton të gjithë kandidatët që përmbushin kriteret ligjore për të kandiduar brenda një afati 10-ditor. Ky afat fillon: a) Të paktën 60 ditë para datës së mbarimit të mandatit të kryetarit në detyrë; b) Të paktën 10 ditë pas mbarimit të parakohshëm të mandatit të kryetarit.

Në vijim, lidhur me caktimin e ditës së zhvillimit të Mbledhjes së Përgjithshme, është parashikuar afati: 1. Jo me vonë se 3 (tre) ditë nga mbyllja e procedurës për paraqitjen nga kandidatët të shprehjes së interesit për t'u zgjedhur Kryetar, Kryetari i Mbledhjes së Përgjithshme (Kryetari ose Zëvendëskryetari i Gjykatës), cakton ditën e zhvillimit të Mbledhjes së Përgjithshme. 2. Kandidatët paraqesin para Mbledhjes së Përgjithshme platformën e tyre.

Neni 7, i kësaj rregulloreje është një detajim i nenit 51/5 të Ligjit "Për Statusin" sa i përket modaliteteve të thirrjes së Mbledhjes së Përgjithshme dhe afateve të thirrjes së saj, me mundësitë e thirrjes së Mbledhjes së Përgjithshme nga Kryetari ose Zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë. 1. Kryetari i Gjykatës së Lartë njofton thirrjen e Mbledhjes së Përgjithshme, si dhe shpërndan listën e kandidatëve që kanë shprehur interesin për Kryetar, anëtarëve të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjykatës së Lartë të paktën një muaj para mbarimit të mandatit. Mbledhja e Përgjithshme zhvillohet të paktën dy javë para mbarimit të mandatit të Kryetarit. 2. Zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë njofton thirrjen e Mbledhjes së Përgjithshme, si dhe shpërndan listën e kandidatëve që kanë shprehur interesin për kryetar, anëtarëve të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjykatës së Lartë të paktën dy javë pas kalimit të afatit të mbarimit të parakohshëm të mandatit të Kryetarit. Mbledhja e Përgjithshme zhvillohet të paktën një muaj pas mbarimit të parakohshëm të mandatit të Kryetarit.

Në vijim, në nenin 8 është parashikuar Përgatitja e Mbledhjes së Përgjithshme, një procedurë e cila udhëhiqet nga kancelari i Gjykatës së Lartë, me këtë parashikim: 1. Kancelari i Gjykatës së Lartë ndihmon Kryetarin e Mbledhjes së Përgjithshme në përgatitjen dhe mbarëvajtjen e zhvillimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve dhe është veçanërisht përgjegjës për: a) Njoftimin e gjyqtarëve për datën dhe orën e mbledhjes; b) Mbledhjen e kërkesave për shprehjen e interesit nga gjyqtarët që duan të kandidojnë sipas modelit aneks 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje; c) Përgatitjen e fletës së votimit sipas modelit aneksi 2 bashkëlidhur kësaj rregulloreje; ç) Ngritjen e komisionit të votimit të përbërë nga kancelari, kryesekretari dhe një sekretar gjyqësor; d) Numërimin e votave dhe shpalljen e rezultatit; dh) Marrjen e masave për regjistrimin audio të mbledhjes, nëse është i mundur realizimi i regjistrimit; 2. Në mungesë të Kancelarit

këto përgjegjësi i ushtron Kryesekretari/ja e Gjykatës së Lartë dhe në mungesë të tij/saj nga sekretari/sekretarja me përvojën profesionale me të gjatë në Gjykatën e Lartë.

Në nenin 9, të titulluar “Verifikimi i kriterëve për kandidatët”, parashikohet se: 1. Para zhvillimit të mbledhjes, Kryetari i Mbledhjes së Përgjithshme verifikon përmbushjen e kriterëve të kandidatëve dhe përgatit listën e kandidatëve. Për këtë qëllim, Kryetari i Mbledhjes së Përgjithshme mund të kërkojë informacion nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Neni 10, titulluar “Pjesëmarrja në Mbledhjen e Përgjithshme”, parashikon detyrueshmërinë e anëtarit të Gjykatës së Lartë për të marrë pjesë personalisht në mbledhje, si edhe kuorumin e nevojshëm për vlefshmërinë e mbledhjes. Gjithashtu një parashikim të posaçëm ka sa i përket mosformimit të kuoromit të nevojshëm. Ky nen ka këtë parashikim: 1. Në Mbledhjen e Përgjithshme marrin pjesë të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë. Mbledhja është e vlefshme kur në të marrim pjesë jo më pak se 2/3 e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Gjyqtarët e pranishëm në mbledhje kanë për detyrë të votojnë. Gjyqtari merr pjesë personalisht dhe nuk mund të përfaqësohet nga një gjyqtar tjetër. 2. Në rast se në Mbledhjen e Përgjithshme janë të pranishëm më pak se numri i parashikuar në pikën 2 të këtij neni, Kryetari i mbledhjes shtyn mbledhjen dhe cakton një datë tjetër për zhvillimin e saj.

Në nenin pasues, parashikohet “Drejtimi i Mbledhjes së Përgjithshme nga ana e kryetarit të Gjykatës së Lartë”. Gjithashtu është parashikuar dokumentimi i procedurës së zhvillimit të mbledhjes në një procesverbal, i cili nënshkruhet nga Kryetari i mbledhjes dhe një sekretare e ngarkuar për mbajtjen e tij. Ky nen ka këtë formulim. 1. Kryetari i mbledhjes merr masa për zhvillimin normal të Mbledhjes së Përgjithshme dhe e drejton atë deri në daljen e rezultatit përfundimtar. 2. Procedura e zhvillimit të Mbledhjes së Përgjithshme pasqyrohet në një procesverbal, i cili nënshkruhet nga Kryetari i mbledhjes dhe sekretarja e ngarkuar për mbajtjen e tij.

Kreu III i këtij akti i dedikohet një organi të rëndësishëm për Mbledhjen e Përgjithshme, i cili është Komisioni i Votimit, i ngarkuar me zhvillimin e procedurës së votimit dhe shpalljen e rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës nga Mbledhja e Përgjithshme.

Në nenin 12 parashikohet përmbajtja e Komisionit të Votimit për zhvillimin e procedurës së votimit dhe shpalljen e rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës nga Mbledhja e Përgjithshme. Ai përbëhet nga Kancelari, Kryesekretari/ja dhe sekretari/ja me përvojën profesionale me të gjatë në atë gjykatë. Gjithashtu në këtë nen ka edhe një parashikim për mekanizëm zhbllokues, në rast të pamundësisë për konfigurimin e mësipërm. Ky nen është i formuluar si vijon: 1. Për zhvillimin e procedurës së votimit dhe shpalljen e rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës nga Mbledhja e Përgjithshme, krijohet komisioni i votimit. 2. Në fillim të mbledhjes, drejtuesi i saj lexon emrat e kandidatëve për pozicionin e Kryetarit të Gjykatës dhe ngre komisionin e votimit. Në komisionin e votimit merr pjesë në mungesë të Kancelarit ose të Kryesekretarit/es, vendin e tyre në komisionin e votimit e merr sekretari i radhës me përvojën më të gjatë profesionale në Gjykatën e Lartë. Në rast pamundësie, Kryetari i Mbledhjes së Përgjithshme mund të ngrejë komisionin e votimit me një tjetër konfigurim me pjesëmarrjen e punonjësve të tjerë të gjykatës. Kancelari, dhe në mungesë të tij, Kryesekretari/ja drejton komisionin e votimit.

Neni pasues i titulluar “Rregullat e votimit”, parashikon që përpara fillimit të votimit, komisioni i votimit shpjegon mënyrën dhe rregullat e votimit. Ky nen ka këtë formulim. 1. Përpara fillimit të votimit, komisioni i votimit shpjegon mënyrën dhe rregullat e votimit.

Në nenin 14 është e detajuar përmbajtja e fletës së votimit, e cila hartohet sipas modelit në aneks nr.2, ku janë përcaktuar elementët thelbësore të saj. Renditja e kandidatëve bëhet sipas rendit alfabetik. Ky nen ka këtë formulim 1. Votimi bëhet duke përdorur fletën e votimit, të miratuar sipas modelit të aneksit nr. 2 bashkëlidhur kësaj rregulloreje. 2. Kandidatët renditen në fletën e votimit sipas rendit alfabetik. 3. Fleta e votimit përmban elementet e mëposhtëm: a) Emri dhe mbiemri i plotë i kandidatit/kandidatëve; b) Vendin e posaçëm për votim; c) Një shënim në fund të fletës së votimit ku renditen shkaqet ligjore të pavlefshmërisë së votës.

Në nenin 15 është parashikuar procesi i votimit e shoqëruar me detyrat e anëtarëve të Komisionit të Votimit. Është parashikuar që ky votim të jetë i fshehtë. Është zgjedhur forma e votimit të fshehtë duke mbajtur në konsideratë rregulloren e miratuar

nga Gjykata e Lartë në rastin kur ajo përzgjedh propozimin e KED-së për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese. Janë parashikuar edhe një set rregullash të detyrueshme për të t'u ndjekur nga votuesit. Ky nen ka këtë përmbajtje: 1. Votimi për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës është i fshehtë dhe individual. 2. Procesi i votimit është i mbyllur dhe rezultati i votimit bëhet publik menjëherë. 3. Pas shpjegimit të rregullave të votimit, komisioni vijon me procedurën e votimit për Kryetarin e Gjykatës së Lartë. 4. Anëtarët e komisionit të votimit nënshkruajnë dhe vulosin të gjitha fletët e votimit, të cilat janë të barabarta me numrin e gjyqtarëve të pranishëm në Mbledhjen e Përgjithshme. 5. Komisioni i votimit i dorëzon çdo gjyqtari fletën përkatëse të votimit, i cili e plotëson atë në dhomën e fshehtë, e më pas e hedh në kutinë e votimit. 6. Çdo gjyqtar ka të drejtën e një vote dhe votimi me përfaqësim nuk lejohet. Abstenimi nuk lejohet. 7. Gjyqtarët ndjekin rregullat e votimit si vijon: a) votohet vetëm në fletën e votimit të vënë në dispozicion nga komisioni i votimit; b) votohet duke vendosur në kutinë përkatëse, përbri emrit të kandidatit të preferuar, shenjat që mund të jenë “+” ose “x” ose “v”.

Në nenin 17 është parashikuar procesi i numërimit të votave nga Komisioni i Votimit. Ky është një proces që zhvillohet i hapur dhe në prani të të gjithë anëtarëve të Mbledhjes së Përgjithshme. Ky nen ka këtë përmbajtje. 1. Pas përfundimit të votimit, komisioni i votimit hap kutinë në praninë e të gjithë gjyqtarëve të Mbledhjes së Përgjithshme, fillon numërimin e votave dhe vijon me nxjerrjen e rezultatit përfundimtar të votimit. 2. Procesi i numërimit të fletëve të votimit dhe i nxjerrjes së rezultatit të votimit është i hapur. 3. Çdo fletë votimi i tregohet gjyqtarëve të pranishëm në mbledhje. 4. Komisioni i votimit vlerëson fillimisht votat e vlefshme dhe pastaj fillon numërimin e tyre.

Kreu IV i dedikohet shpalljes së rezultatit. Procesi i numërimit të votave dokumentohet me procesverbalin përkatës të mbajtur nga Komisioni i Votimit. Renditja e kandidatëve bëhet sipas votave që kanë marrë. Në përfundim të procesit të votimit konsiderohet i zgjedhur për pozicionin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë kandidati që ka shumicën absolute të votave të të gjithë anëtarëve të Mbledhjes së Përgjithshme.

Neni 18 ka formulimin e mëposhtëm. Shpallja e rezultatit të votimit 1. Komisioni i votimit, pas përfundimit të numërimit të votave, rendit kandidatët sipas votave që

kanë marrë. 2. Në fund të procesit të votimit dhe të numërimit të votave mbahet një procesverbal, i cili tregon numrin e pjesëmarrësve, të votave të hedhura, numrin e votave të pavlefshme në qoftë se ka, numrin e votave për çdo kandidat dhe emrat e kandidatëve të përzgjedhur. Rastet e mosmarrëveshjeve për vlefshmërinë e votave dhe mënyra e zgjidhjes së tyre shënohen në procesverbal. Në procesverbal shënohet edhe numri i fletëve të votimit që janë zëvendësuar për shkak të dëmtimit. 3. Në përfundim të procesit të votimit konsiderohet i zgjedhur për pozicionin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë kandidati që ka shumicën absolute të votave të të gjithë anëtarëve të Mbledhjes së Përgjithshme. 4. Në rast se në votimin e parë asnjë nga kandidatët nuk arrin shumicën absolute të votave të të gjithë anëtarëve, organizohet menjëherë një raund i dytë votimi mes dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave. Nëse edhe në votimin e dytë asnjë nga kandidatët nuk merr numrin e nevojshëm të votave, kandidati me numrin më të madh të votave konsiderohet i zgjedhur si Kryetar i Gjykatës së Lartë. Në rastet e një barazimi votash, ka përparësi kandidati me përvojë profesionale më të gjatë si magjistrat në profilin gjyqtar.

Neni pasues parashikon dokumentimin e procesit të votimit. 1. Kancelari ose në mungesë të tij kryetari i komisionit të votimit, dokumenton të gjithë procesin e votimit dhe numërimit dhe harton listën e kandidatëve të renditur sipas numrit të votave të marra.

Në vijim ky akt ka parashikuar njoftimin e vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë. Ky vendim i përcillet Këshillit të Lartë Gjyqësor, Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, si dhe Qendrës së Botimeve Zyrtare për botim në Fletoren Zyrtare. Neni 20 ka këtë përmbajtje. 1. Vendimi i Mbledhjes së Përgjithshme për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë i përcillet Këshillit të Lartë Gjyqësor, Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, si dhe Qendrës së Botimeve Zyrtare për botim në Fletoren Zyrtare.

Në këtë akt janë parashikuar edhe dispozitat kalimtare që kanë të bëjnë me rastin kur zgjedhja e Kryetarit të Gjykatës së Lartë nuk është bërë e mundshme sipas 51 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Në këtë rast kompetencat e Kryetarit për ftesën për kandidatët, shpalljen e

thirrjes për shprehjen e interesit bëhen nga Zëvendëskryetari i Gjykatës. Një afat i posaçëm për shpalljen e thirrjes për shprehjen e interesit është parashikuar në këtë dispozitë dhe lidhet me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, konkretisht brenda 1 (një) muaji nga hyrja në fuqi e saj.

Neni 21 ka këtë përmbajtje që unë e thashë më sipër.

Së fundmi është parashikuar edhe hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, konkretisht me miratimin e saj nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe gjithashtu shoqërohet me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Gjykatës së Lartë.

Kjo rregullore shoqërohet gjithashtu me 2 anekse, aneks 1 – ku paraqitet formulari për shprehje interesi të kandidatit dhe Aneks 2 – ku pasqyrohet formati i fletës së votimit.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, ftoj kolegët nëse kanë ndonjë diskutim përpara se ta hedh në votim.

**Brikena Ukperaj:** Kryetare mundem?

**Naureda Llagami:** Po!

**Brikena Ukperaj:** Duke e konsideruar relacionin e përgatitur nga KZHK që u relatua nga zoti Kurushi, konstatoj që ky është një draft i përgatitur nga KZHK-ja. Po? Zoti Kurushi?

**Klodian Kurushi:** Po!

**Brikena Ukperaj:** I cili bazohet në dy modele ose rregullore të miratuara më parë: i) rregullorja e zgjedhjes së zëvendëskryetarëve që ka miratuar Këshilli i Lartë Gjyqësor (ka qenë akti i parë i miratuar nga Këshilli); si dhe zoti Kurushi e saktësoi, nuk është rregullorja për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, sepse

Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi përcaktohet nga ligji se si zgjidhet, por është ii) rregullorja e miratuar nga Gjykata e Lartë për zgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese për të cilat ajo ka qenë organ emërtese. Këto janë dy aktet. Nga faqja e internetit të Gjykatës së Lartë më rezulton që në fakt ka edhe një draft të përgatitur nga Gjykata e Lartë lidhur me këtë çështje.

Në mbledhjen e datës 02.03.2023, Këshilli i Gjykatës së Lartë është mbledhur dhe ka miratuar edhe ai një draft rregullore për zgjedhjen e zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë. Në këtë mbledhje (procesverbalin e mbledhjes e kam nxjerrë nga faqja e internetit të Gjykatës së Lartë) është shtruar për diskutim kompetenca e organit për miratimin e rregullave për zgjedhjen e kryetarit; nëse ishte kompetencë e Këshillit të Lartë Gjyqësor apo nëse ishte kompetencë e Këshillit të Gjykatës së Lartë.

Në këtë mbledhje, ku ka marrë pjesë edhe një përfaqësues i KLGJ-së për të formuar kuorumin e mbledhjes së Këshillit të Gjykatës, është miratuar njëzëri projektregullorja për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe është përcjellë për vlerësim në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Pra ka një draft rregullore të Gjykatës së Lartë e cila, të paktën nga procesverbali më rezulton që duhet të jetë përcjellë në Këshillin e Lartë Gjyqësor që në datën 02.03.2023.

Është marrë parasysh kjo projektregullore, zoti Kurushi, në hartimin e këtyre rregullave që ka bërë komisioni?

**Klodian Kurushi:** Po, atëherë edhe kjo projektregullore është marrë parasysh për hartimin e rregullave, dhe kjo projektregullore ka ngjashmëri me rregulloren e miratuar Gjykata e Lartë për votimin e kandidatëve të përcjellë nga KED-ja për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Kështu që e kemi marrë edhe këtë në konsideratë. Kemi marrë në konsideratë edhe rregulloren e Gjykatës së Lartë dhe kemi parë që përmbajtja e dispozitave është e njëjtë.

**Brikena Ukperaj:** Pra është përcjellë zyrtarisht ky draft nga Gjykata e Lartë?

E keni zyrtarisht të përcjellë këtë draft?



**Klodian Kurushi:** Po, po, zyrtarisht.

**Brikena Ukperaj:** Pra paskemi edhe këtë draft të përcjellë nga Gjykata e Lartë.

Në fakt zonja Kryetare unë do të kërkoja që të njihesha më nga afër me draftin e përcjellë nga Gjykata e Lartë për të parë në fakt cila është qasja. Projektregullorja që ne miratojmë ka disa gjëra të diskutueshme lidhur me çështjen e votimit dhe çështjen e verifikimit të kandidatëve për kryetar të Gjykatës së Lartë. Nga ana tjetër konstatoj që ka edhe disa rudimente të mbetura nga rregullorja e zgjedhjes së anëtarit për Gjykatë Kushtetuese, siç është për shembull rasti i dërgimit për publikim në Fletore Zyrtare. Nuk ka pse vendimi për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë të çohet për publikim në Fletoren Zyrtare. Pra ka disa momente që duhet të reflektohen.

Nuk i kam bërë sot, për arsye, sepse unë nuk e kisha draft rregulloren e Gjykatës së Lartë dhe nga zoti Kurushi nuk e kemi si material, as në relacion nuk citohej dhe as nuk e kemi si material bashkëlidhur për të parë ndryshimet dhe si ka qenë qasja.

E dyta, në relacionin e zotit Kurushi përmendet që në fakt ka pasur disa komente të gjyqtarit {...} lidhur me këtë projektregullore, të cilat nga Gjykata e Lartë nuk janë konsideruar relevante të themi, lidhur me këtë projektregullore. Por duke qenë se Këshilli tashmë e ka kompetencën për miratimin e kësaj rregulloreje, unë vlerësoj që, duke qenë se bëhet fjalë për disa komente të një anëtari të Gjykatës së Lartë, t'i kisha edhe ato komente në dispozicion. Pra do kërkoja kohë që pasi të më viheshin në dispozicion draft rregullorja e përgatitur nga Gjykata e Lartë bashkë me komentet e zotit {...}, të jepja qëndrimin tim lidhur me propozimet që mund të kisha për përmirësimin e saj.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Zoti Kurushi, mund t'i kemi në dispozicion? Kemi mbajtur edhe standardin që kur kërkojmë informacion...

**Klodian Kurushi:** Patjetër!

Patjetër që do t'i vëmë në dispozicion edhe mendimin e zotit {...}.

Vetëm ndoshta për orientim. Zoti {...} në propozimet e tij ka shtuar përveç zgjedhjes së Kryetarit, edhe zgjedhjen e Zëvendëskryetarit në të njëjtën rregullore. Kjo është arsyeja pse Gjykata e Lartë më pas nuk e ka përkrahur, nuk ka bërë koment për mendimet që ka dhënë zoti {...}. Ai në një projektregullore ka dashur të fusë si zgjedhjen e Kryetarit ashtu edhe zgjedhjen e Zëvendëskryetarit. Kjo është.

*Naureda Llagami:* Atëherë, duke qenë se aktet janë të administruara nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, mund t'i ndajmë aktet dhe në këtë moment e shtyjme çështjen. Pasi të na vihen në dispozicion aktet, për të lejuar më pas vendimmarrjen mbi këtë projekt-akt. Shtyhet për mbledhjen e radhës.

\* \* \*

(Pika 3 të rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 27.06.2023)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtim i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, gjatë ushtrimit të detyrës së inspektorit pranë Inspektoratit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, (relatore znj. Yllka Rupa).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:57 dhe mbaroi në orën 13:32.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

*10. Brikena Ukperaj* (anëtare)

*11. Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

*1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

*2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

*3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

*4. Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*

*5. Sarmela Titka, Përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*

*6. Valbona Bala, Eksperte (EWMI).*

*7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

*8. BIRN.*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtim i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, gjatë ushtrimit të detyrës së inspektorit pranë Inspektoratit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, (relatore znj. Yllka Rupa).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}.

Fjalën ia jap zonjës Rupa.

*Yllka Rupa:* Faleminderit Kryetare!

Do të parashtoj përpara mbledhjes projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarin {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016.

Projektraporti i vlerësimit për gjyqtarin {...} ka për qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin), që ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit

kalimtar me vendim të formës së prerë. Gjyqtari i cili ka ushtruar detyrën e inspektorit pranë Inspektoratit të ish-KLGJ-së për periudhën përkatëse, vlerësohet në drejtim të etikës dhe veprimtarisë profesionale me qëllim përcaktimin e shkallës së aftësisë së tij e cila nuk mund të jetë në nivel “pamjaftueshëm” pasi gjyqtari është vlerësuar i aftë nga organet e rivlerësimit kalimtar.

Në projektraport pasqyrohet sipas rendit kronologjik i gjithë procesi i gradimit të gjyqtarit, gjithashtu procedura e ndjekur, burimet e vlerësimit dhe evidentimi i të dhënave që rezultojnë prej tyre, mbi bazën e të cilave unë do të raportoj lidhur me vlerësimin, nivelin e pikëzimit për secilin nga katër kriteret e vlerësimit për këtë gjyqtar.

Lidhur me kriterin e parë “Aftësitë profesionale”, “Njohuritë ligjore”, 1.A.a Aftësia hulumtuese, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave- Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari i komanduar në pozicionin e inspektorit pranë Inspektoratit të ish-KLD-së, ka aftësi shumë të mira për të paraqitur në mënyrë koncize dhe të përmbledhur objektin e çështjes/ankesës, paraqitjen e fakteve në mënyrë kronologjike si dhe pasqyrimin e veprimeve të kryera gjatë procedurës së verifikimit. Gjithashtu, evidentohet aftësia e tij për të identifikuar informacionin mbi të cilin ka filluar inspektimi si dhe për t’u përqendruar mbi pretendimet konkrete të ankuesit apo çdo aspekt tjetër brenda objektit të verifikimit. Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, evidentohet aftësia e tij për t’u referuar dhe për t’u ndalur vetëm në atë çfarë konsiderohet e rëndësishme në trajtimin e çështjes/ankesës, duke shmangur trajtimin e elementëve jo të rëndësishëm që mund të përmbajë çështja objekt verifikimi. Evidentohet gjithashtu, aftësia e tij për të identifikuar normat dhe aktet ligjore apo nënligjore të zbatueshme në drejtim të analizës mbi çështjen konkrete, ndërsa në lidhje me rastet e konfliktit të normave, nuk rezulton që nga ana e tij të jenë analizuar raste të tilla, kjo për shkak të natyrës së çështjeve burim vlerësimi, për të cilat nuk ka qenë e nevojshme një trajtim i tillë.

Për këtë arsye, lidhur me këtë tregues propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë dhe niveli i pikëzimit 25 pikë.

Për të kaluar tek 1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin - Referuar të dhënave rezulton se gjyqtari {...}, gjatë ushtrimit të detyrës në pozicionin e inspektorit, ka shfaqur aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit të ligjit të zbatueshëm, në funksion të trajtimit dhe zgjidhjes së çështjes/ankesës. Gjithashtu, në një rast, evidentohet identifikimi dhe referimi në jurisprudencën relevante, duke i dhënë vlerë të veçantë interpretimit të ligjit të zbatueshëm dhe aplikimit të tij në çështjet objekt verifikimi. Parimet e përgjithshme të së drejtës, nuk referohen apo trajtohen në mënyrë të drejtpërdrejtë por, gjejnë zbatim në përmbajtje të interpretimit dhe analizës së fakteve konkrete të çështjeve objekt verifikimi.

Edhe lidhur me këtë komponent propozohet që niveli i vlerësimit të jetë shumë i lartë dhe pikëzimi 25 pikë.

Në lidhje me “Arsyetimin ligjor”, 1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e akteve, rezulton se gjyqtari i komanduar në pozicionin e inspektorit tregon kujdes për pasqyrimin e qartë, konciz dhe të saktë të ankesës apo çështjes objekt verifikimi, të fakteve të çështjes, ecurisë procedurale të trajtimit të rastit, evidentimit të dokumenteve dhe informacioneve të marra në kuadër të verifikimit, përcaktimit të çështjeve që përbëjnë objektin e verifikimit dhe vlerësimit, arsyetimin ligjor dhe paraqitjen e konkluzionet të saj në formën e sugjerimit lidhur me trajtimin e rastit.

Në lidhje me këtë tregues propozohet vlerësimi shumë i lartë dhe pikëzimi me 15 pikë.

Për të kaluar tek 1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e dokumentave ligjorë – edhe për sa i përket këtij komponenti, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të dokumentit ligjor, pavarësisht përmbajtjes që ka secila ndarje. Në të gjitha dokumentet ligjore të analizuara, ndjekja e një strukture të njëjtë, të mirëpërcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike e rrjedhshmërisë së mendimit juridik, nga njëra pjesë e dokumentit ligjor në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin.

Kështu që në këto kushte, edhe lidhur me këtë komponent propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë dhe pikëzimi me 10 pikë.

Për sa i përket 1.B.c. Cilësia e analizës dhe argumentimi logjik - Në tërësi, në dokumentet ligjore të analizuara, analiza ligjore dhe shkalla e argumentimit logjik, pavarësisht se në masë të ndryshme, kushtëzuar nga natyra komplekse ose jo e çështjes, rezulton e lartë. Evidentohet aftësia e tij në analizimin e qartë të fakteve thelbësore të çështjes që lidhen me ankimin/çështjen objekt trajtimi, duke i analizuar ato në disa raste jo komplekse në mënyrë të përmbledhur dhe në rastet komplekse në mënyrë të detajuar por, në çdo rast në mënyrë logjike dhe të kuptueshme.

Në këto kushte, referuar në sa parashtrova, propozoj që gjyqtari të vlerësohet me një nivel vlerësimi shumë të lartë dhe të pikëzohet me 25 pikë.

Në lidhje me kriterin e parë “Aftësitë profesionale”, propozohet niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm” dhe i pikëzimit 100 pikë.

Për të kaluar tek “Aftësitë organizative të gjyqtarit”, “2.A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë”, (2.A.a. Aftësia për të realizuar volumin normal të punës) - Duke iu referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, rezulton se z. {...} për periudhën kohore 08.10.2013-08.10.2016, ka përfunduar 535 çështje (ankesa të trajtuara) duke hartuar raportet përkatëse, duke tejkaluar standardin sasior me 85 çështje ose rreth 18.8% të standardit sasior që ka qenë në fuqi.

Në këto kushte propozohet që për këtë komponent gjyqtari të pikëzohet me 25 pikë.

Në lidhje me 2.A.b. Aftësia për të respektuar afatet, rezulton se në 4 (katër) prej çështjeve të analizuara, materialet janë trajtuar dhe përfunduar nga gjyqtari i komanduar {...}, në cilësinë e inspektorit, brenda afateve të zbatueshme. Vetëm për 1 (një) çështje, është tejkaluar afati 30-ditor për trajtimin e saj. Gjithashtu, në aktin e vlerësimit të miratuar me vendim të KLD-së për periudhën kohore 2013-2014, në drejtim të treguesit të shpejtësisë, z. {...} është vlerësuar “Mirë”, në kushtet kur është analizuar se për vitin 2013 inspektori ka realizuar 28.9% të raporteve jashtë afatit standard dhe në vitin 2014 ka rezultuar 40% të raporteve të jenë jashtë këtij afati.

Në kushtet kur, nga 5 (pesë) çështjet e analizuara, vetëm për 1 (një) prej tyre, materiali është përfunduar nga gjyqtari i komanduar në tejkallim të afatit 30-ditor të shqyrtimit të tij, vlerësoj se aftësitë e tij në drejtim të respektimit të afateve në trajtimin

e çështjeve, sipas të dhënave burimore në lidhje me kohën e trajtimit të tyre, dhe të dhënave të tjera nga burimet e vlerësimit, duke marrë në konsideratë dhe ngarkesën e z. {...} në periudhën e vlerësimit, duhet të vlerësohet maksimalisht me 25 pikë.

Në lidhje me “2.B. Efektiviteti dhe metodologjia”, 2.B.a Aftësia për të përcaktuar veprimet procedurale dhe planin e punës, rezulton angazhimi maksimal i gjyqtarit të komanduar për përshtatjen dhe ndjekjen e një metodologjie efektive në drejtim të organizimit të punës dhe për pasojë, aftësitë e tij për këtë tregues, duket të vlerësohen maksimalisht. Propozohet edhe për këtë komponent nivelin e vlerësimit shumë të lartë dhe nivelin e pikëzimit 25 pikë.

Për sa i takon “2.C. Rregullshmërisë dhe saktësisë së dokumentacionit”, 2.C.a Rregullshmëria e mbajtjes së dokumentacionit - Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se aktet e dosjes janë të administruara dhe renditura në mënyrë të rregullt, duke ndjekur rendin kronologjik të paraqitjes apo hartimit të tyre dhe në tërësi e bëjnë materialin lehtësisht të shfrytëzueshëm nga çdo përdorues.

Në këto kushte propozohet një nivel pikëzimi me 10 pikë.

Për sa i përket 2.C.b Saktësisë dhe plotësisë së dokumentacionit, edhe për këtë komponent nuk rezultojnë mungesa të dokumentave në praktikën e trajtimit të rasteve burim vlerësimi dhe as prania e akteve që nuk i përkasin çështjes respektive.

Kështu që, edhe për këtë tregues propozohet nivelin e vlerësimit shumë të lartë dhe i pikëzimit 15 pikë.

Në këto kushte, lidhur me kriterin “Aftësitë organizative të gjyqtarit” propozohet nivelin e vlerësimit “Shkëlqyeshëm” dhe pikët 100.

Për të kaluar tek “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, “Etika në punë”, 3.A.a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion - rezulton se gjyqtari {...}, gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit të komanduar, ka reflektuar angazhim dhe përgjegjshmëri maksimale në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, edhe për këtë tregues propozohet një nivel pikëzimi me 35 pikë.

“3.B Integriteti i gjyqtarit të komanduar” vlerësohet në komponentin 3.B.a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti – Referuar të dhënave që



rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë indicie apo e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit. Për këtë tregues propozohet gjithashtu një nivel vlerësimi shumë i lartë dhe nivel pikëzimi me 40 pikë.

“3.C Paanësia e gjyqtarit të komanduar”, 3.C.a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese - Referuar të dhënave, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin verbal ose përmbytjen e dokumenteve ligjore të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se z. {...} ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese dhe për këtë arsye propozohet nivel vlerësimi shumë i lartë dhe nivel pikëzimi me 10 pikë.

Në lidhje me 3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar për përjashtim, si dhe atyre të refuzuara për heqjen dorë të gjyqtarit të komanduar nga një procedurë administrative - duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, pavarësisht detyrës që ai ushtron përkohësisht si i komanduar, në mungesë të të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar për përjashtim apo për heqje dorë të refuzuara më parë për të njëjtin shkak, në kushtet kur në rastet e gradimit dispozitat e Ligjit për Statusin dhe aktet e Skemës së Vlerësimit të dala në bazë të këtij ligji, zbatohen për aq sa është e mundur, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar për përjashtim, si dhe atyre të refuzuara për heqjen dorë të gjyqtarit të komanduar nga një procedurë administrative, për inspektorin {...} është i pakonsiderueshëm. Për këtë shkak, ky komponent propozohet të vlerësohet me 15 pikë.

Në mënyrë të përmbledhur, lidhur me kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” propozohet të jetë niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”, pikëzimi 100.

Për të kaluar tek kriteri i fundit mbi bazën e të cilit vlerësohen “Aftësitë profesionale dhe angazhimi profesional”. 4.A. Aftësia e komunikimit, 4.A.a. Komunikimi i qartë dhe transparent - rezulton se gjyqtari i komanduar z. {...} ka komunikim të qartë dhe transparent në komunikimin verbal si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e dokumenteve ligjore të hartuara prej tij.

Në këto kushte propozohet për këtë komponent niveli i vlerësimit shumë i lartë dhe i pikëzimit me 25 pikë.

Për sa i takon 4.A.b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale - Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Lidhur me këtë tregues propozohet niveli i vlerësimit i lartë, duke u pikëzuar me 15 pikë.

Për të kaluar tek 4.B. Aftësia për të bashkëpunuar, 4.B.a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, shkëmbimi i njohurive dhe i përvojës profesionale - në mungesë të të dhënave, të drejtpërdrejta apo të tërthorta, për mungesën e bashkëpunimit dhe ndërveprimit me kolegët, si dhe duke analizuar të dhënat burimore që tregojnë aftësi të larta të tij në këtë drejtim, rezulton e qartë se ky bashkëpunim ka ekzistuar dhe ka qenë në nivel të lartë.

Niveli i vlerësimit për këtë komponent propozohet shumë i lartë dhe i pikëzimit me 10 pikë.

Në lidhje me 4.B.b. Gatishmëria dhe kontributi për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen nga strukturat drejtuese të Këshillit - Nga të dhënat e analizuar në raportin e analizimit të aftësive profesionale të rivlerësimit dhe në aktin e vlerësimit të miratuar me vendimin e KLD nr. {...}, datë 20.06.2016, për periudhën e vlerësimit 2013-2014, rezulton angazhimi i inspektorit në kryerjen e detyrave të tjera që i janë ngarkuar nga strukturat drejtuese të KLD-së sikurse citohet në kriterin në lidhje me angazhimin e tij profesional, ku gjatë kësaj periudhe vlerësimi, inspektori {...} ka qenë anëtar i Komisionit për shqyrtimin e kandidaturave për emërimin e inspektorëve. Po ashtu, ai është caktuar edhe përgjegjës i grupeve të kontrollit në disa raste të inspektimit tematik.

Duke qenë në këto kushte, niveli i pikëzimit për këtë komponent propozohet të jetë 5 pikë.

4.B.c Aftësia për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevoje - Referuar të dhënave, vlerësoj se shkalla e bashkëpunimit dhe aftësia për të reaguar me efikasitet në rast nevoje për gjyqtarin {...} është shumë e lartë dhe duhet të pikëzohet maksimalisht. Pra niveli i pikëzimit propozohet të jetë 10 pikë.

4.C Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, 4.C.a Pjesëmarrja në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale - gjatë periudhës së vlerësimit, rezulton se {...} ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e pjesëmarrësit në këto aktivitete: (i) Trajtimi me temë “Forcimi i mekanizmave inspektues dhe bashkëpunimi i tyre në verifikime e shkeljeve të etikës gjyqësore”, gjithsej 2 ditë trajnimi; (ii) Trajnimi me temë “Etika Profesionale”, gjithsej 1 ditë trajnimi.

Gjithashtu, rezulton se z. {...}, ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, në cilësinë e pjesëmarrësit në 3 (tre) trajnime të zhvilluara brenda periudhës së rivlerësimit si më poshtë: (iii) Trajnim me temë “Etika gjyqësore”, organizuar nga Ambasada Britanike dhe OPDAT, zhvilluar në Tiranë, 1 ditë trajnimi; (iv) Trajnim me temë “Inspektimi i shkeljeve të etikës gjyqësore”, organizuar nga OPDAT dhe Ambasada Franceze, zhvilluar në Tiranë, 3 ditë trajnimi; (v) Trajnim me temë “Përdorimi i sistemit të regjistrimit digjital audio në gjykata dhe monitorimi i përdorimit të tij në sallën e gjyqit”, organizuar nga USAID, zhvilluar në Tiranë, një ditë trajnimi.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, referuar të dhënave lidhur me angazhimin e gjyqtarit në aktivitete trajnuese brenda ose jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, gjatë periudhës 2013-2016, pikëzimi për këtë tregues, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, do të jetë 20 pikë, meqenëse për periudhën 3-vjeçare rezulton pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në 2 ditë trajnimi dhe pjesëmarrja në saj në aktivitet trajnues jashtë këtij programi, zhvilluar në 5 ditë trajnimi.

Edhe për këtë komponent propozohet niveli i pikëzimit me 2 pikë.

Në lidhje me 4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit të komanduar për trajnimin e gjyqtarëve - Referuar të dhënave, nuk rezulton që gjyqtari i komanduar të jetë

angazhuar në aktivitete trajnuese si ekspert ose lehtësues në programin e Shkollës së Magjistraturës, dhe për këtë arsye ai duhet të vlerësohet me 3 pikë në lidhje me këtë tregues.

Për sa i takon 4.C.c Pjesëmarrjes në veprimtari të tjera ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë - propozohet të vlerësohet për këtë tregues me 3 pikë, për shkak se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera të kësaj natyre.

Në lidhje me 4.C.ç Publikimet ligjore – nuk rezulton që për periudhën 2013-2016 gjyqtari {...} të ketë publikime ligjore, kështu që për këtë tregues ai do të vlerësohet me 0 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Aftësia personale dhe angazhimi profesional”, propozohet që niveli i vlerësimit të jetë “Shkëlqyeshëm”, ndërsa pikët 91.

Në mënyrë të përmbledhur për të katër kriteret propozohet për nivelin e vlerësimit si më poshtë:

1. Aftësia profesionale, pikët 100, niveli i vlerësimit Shkëlqyeshëm 2. Aftësitë organizative, pikët 100, niveli i vlerësimit Shkëlqyeshëm 3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, pikët 100, niveli i vlerësimit Shkëlqyeshëm 4. Aftësia personale dhe angazhimi profesional, pikët 91, niveli i vlerësimit Shkëlqyeshëm.

Propozimi për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit është 391, niveli i vlerësimit Shkëlqyeshëm.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Nëse kemi diskutime?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga relatorja.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016 gjatë ushtrimit të detyrës së inspektorit pranë Inspektoratit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, duke e vlerësuar atë, si më poshtë:

A. Aftësia profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

B. Aftësia organizative – “Shkëlqyeshëm”;

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

D. Aftësia personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

\* \* \*

(Pika 4 të rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 27.06.2023)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtim i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:57 dhe mbaroi në orën 13:32.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Irena Plaku*** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 7. Ridvan Hado*** (anëtar)

8. *Alban Toro* (anëtar)  
9. *Marçela Shehu* (anëtare)  
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)  
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *Sarmela Titka, Përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
6. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI).*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
8. *BIRN.*

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtim i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin tjetër i cili ka të bëjë me fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

Për më shumë detaje fjalën ia jap zotit Kurushi.

***Klodian Kurushi:*** Faleminderit zonja Kryetare!

Pa humbur kohë po vijoj me parashtrimin e relacionit.

Mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

Këshilli me vendimin nr. 77, datë 13.02.2023, miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës. Në këtë listë janë përfshirë gjithsej 14 (katërbëdhjetë) kandidatë.

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 21, që i referohet pozicionit të lirë të shpallur në fushën e së drejtës civile për Gjykatën e Shkallës së Parë Durrës, është kualifikuar z. {...}, por pas kërkesës së tij për tërheqje nga ky pozicion, Këshilli me vendimin nr. 317, datë 14.06.2023 ka vendosur: “Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi.”

Pas tërheqjes së z. {...} nga kandidimi për pozicionin nr. 21, rezulton se për këtë pozicion mbeten në garë kandidatët: znj. {...}; z. {...} dhe znj. {...}. Këta kandidatë sipas Shtojcës III të vendimit nr.77, datë 13.02.2023, nuk rezulton se mund të kenë ose mund t’u bëhet një vlerësim nga Këshilli.

Mbi projektvendimin “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallur me vendimin nr. 21 datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim”, ne kemi bërë verifikimet dhe vlerësimet tona si Komision.

Lidhur me verifikimin e kandidatëve që kandidojnë për lëvizjen paralele, Këshilli ka miratuar procedura të detajuara përmes Vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”.

Procedura e lëvizjes paralele zhvillohet në tre faza, si më poshtë:



a) në fazën e parë bëhet verifikimi i kandidatëve për plotësimin e kriterëve ligjorë të kandidimit;

b) në fazën e dytë bëhet renditja e kandidatëve të kualifikuar;

c) në fazën e tretë merret vendimi për transferimin e kandidatit të renditur më lart.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit sipas pikës 3 të këtij vendimi, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, Këshilli miraton me vendim listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, të atyre që kanë ose mund të kenë një vlerësim, si dhe të kandidatëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

Pas vendimit të Këshillit sipas pikës 9, fillon faza e parë e procedurës së lëvizjes paralele, ku kandidatët që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, i nënshtrohen fillimisht procesit të verifikimit të plotësimit të kriterëve ligjorë të kandidimit sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 5, të këtij vendimi.

Në rastin kur për pozicionin e lirë në një gjykatë të shkallës së parë nuk ka kandidatë që kanë apo mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale, ose kur kandidatët e kësaj kategorie janë tërhequr nga kandidimi, ose kur ata nuk janë kualifikuar për mosplotësim të kriterëve të kandidimit, procedura e lëvizjes paralele vazhdon për kandidatët sipas shkronjës “a”, të pikës 13, të këtij vendimi. Nëse për të njëjtat arsye procedura e lëvizjes paralele nuk mund të vazhdojë për këtë kategori kandidatësh, atëherë ajo vazhdon për kandidatët sipas shkronjës “b”, të pikës 13, të këtij vendimi. Nëse për të njëjtat arsye procedura e lëvizjes paralele nuk mund të vazhdojë edhe për këtë kategori kandidatësh, atëherë ajo konsiderohet e përfunduar dhe pozicioni rishpallet përsëri.”

Këshilli, me vendimin nr. 77, datë 13.02.2023 ndër të tjera ka vendosur: “Miratimin e listës së gjyqtarëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21; 22; 23 dhe 24, datë 18.01.2023.

Shtojca përmban listën e emrave të gjyqtarëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim. Nuk po i lexoj një nga një. Janë bashkëlidhur relacionit.

Nga lista e gjyqtarëve të përfshirë në Shtojcën III, rezulton se 3 (tre) prej tyre kanë kandiduar në pozicionin nr. 21. Përkatësisht, znj. [...] – gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër; z. [...] - gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe znj. [...] - gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

Në këto kushte, në përputhje me pikën 11 të vendimit, nr. 21/2023, vendimin nr. 320/2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” të Këshillit, Komisioni i propozon Këshillit të miratojë projektvendimin për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Struktura e projektvendimit

Projektvendimi është i strukturuar në 3 pika.

Në pikën e parë parashikohet fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

Në pikën e dytë, caktimin e relatorëve pas zhvillimit të procedurës së shortit për 3 kandidatët të cilët sipas shtojcës III të vendimit nr. 77/2023, që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim janë znj. [...]; z. [...] dhe znj. [...].

Lidhur me procedurën e shortit, do të jetë ajo e ndjekur në rastet e ngjashme; në një enë të hidhen shiritat e letrës me emrat e anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dhe në enën tjetër emrat e 3 (tre) kandidatëve të cilët kanë aplikuar për procedurën e lëvizjes paralele në pozicionin nr. 21 dhe që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim. Më pas, shorti të vijojë me tërheqjen e një prej shiritave të letrës në enën me emrat e anëtarëve të Komisionit, i cili ngarkohet si relator për kandidatin përkatës të zgjedhur në vazhdim tjetër.

Komisioni propozon që secili prej anëtarëve të Komisionit të caktohet relator për 1 (një) kandidat.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë dhe shoqërohet me botimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Atëherë, nëse s'kemi diskutime, kalojmë në procedurën e hedhjes së shortit për tre kandidatët.

Procedura e shortit si vijon:

Në enën e parë vendosen sipas radhës shiritat e letrës me emrat e gjyqtarëve/kandidatëve: znj. [...], z. [...] dhe znj. [...].

Në enën e dytë vendosen sipas rendit alfabetik shiritat e letrës me emrat e relatorëve: z. Alban Toro, z. Dritan Hallunaj dhe z. Klodian Kurushi.

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Emri i parë i përzgjedhur është kandidati z. [...].

Relator për zotën [...], përzgjidhet z. Dritan Hallunaj.

Emri i dytë i përzgjedhur është kandidati znj. [...].

Relator për zonjën [...] përzgjidhet z. Klodian Kurushi.

Emri i tretë i përzgjedhur është kandidatja znj. [...].

Relator për zonjën Gjoni përzgjidhet z. Alban Toro.

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Hedhim në votim projekt-aktin.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë asnjë vlerësim.

2. Caktimin e relatorit si më poshtë:

1. Për kandidaten znj. [...] – relator z. Klodian Kurushi;

2. Për kandidatin z. [...] – relator z. Dritan Hallunaj;

3. Për kandidaten znj. [...] – relator z. Alban Toro.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 5 të rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 27.06.2023)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtim i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 24, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:57 dhe mbaroi në orën 13:32.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

9. *Marçela Shehu* (anëtare)  
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)  
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *Sarmela Titka, Përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
6. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI).*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
8. *BIRN.*

#### **RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtim i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 24, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, për kandidatin z. {...}.

*Alban Toro:* Në kuadër të përpjekjeve që Këshilli i Lartë Gjyqësor bën për të plotësuar vakancat në sistemin gjyqësor në mënyrë të veçantë në Gjykatën e Rrethit

Gjyqësor Tiranë, Durrës dhe në gjykatat e apelit, kanë iniciuar procedurat e lëvizjes paralele me vendimet përkatësisht nga 11-24, datë 18.01.2023 për fillimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, në fushën e së drejtës civile. Gjithashtu kanë filluar disa procedura për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Një nga kandidatët i cili ka konkurruar për disa pozicione dhe konkretisht për pozicionet nr. 11, nr. 24 është edhe zoti {...}, magjistrat pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Kandidati z. {...} në zbatim të pikës 5, të nenit 43, pikas 6 të nenit 48 të ligjit 96/2016 është njoftuar nëpërmjet e-mailit se kandidati nuk mund të kandidojë më shumë se tre pozicione të lira që janë në proces, qofshin këto pozicione procedura ngritjeje në detyrë apo procedura lëvizjeje paralele, pavarësisht kohës së shpalljes së tyre, qenies së tyre në të njëjtën gjykatë apo në të njëjtën fushë të së drejtës.

Pas këtij komunikimi, zoti {...} ka përcjellë elektronikisht në Këshill më datë 20.06.2023 zgjedhjen e tij në lidhje me kandidimet e bëra në procedurat e lëvizjes paralele dhe ato për ngritjet në detyrë duke u përcaktuar tre të tilla. Konkretisht kandidimi për lëvizjen paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 11/2023; kandidimi për lëvizjen paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 24/2023 si dhe kandidimin për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm për një nga pozicionet e lira të shpallura nga Këshilli.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit, nga ana e Këshillit është miratuar lista e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale dhe gjithashtu janë kryer disa veprime procedurale me qëllim verifikimin e kriterëve formale për zotin {...} si dhe të mundësisë së vlerësimit të tij.

Më konkretisht me vendimin nr. 115, datë 13.03.2023 ka filluar procedura e verifikimit për kriteret ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjes paralele në

Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës, të shpallura me vendimin nr. 11, nr. 24, datë 18.01.2023. Gjithashtu me vendimin nr. 202, datë 26.04.2023 nga ana e Këshillit është kualifikuar kandidati {...} dhe është vijuar procedura e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 11, nr. 24, datë 18.01.2023. Ndërkohë që me vendimin nr. 294, datë 30.05.2023, Këshilli ka vendosur fillimin e procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, për pozicionet e shpallura përkatësisht me vendimet nr. 11 – nr. 24, 18.01.2023.

Më datën 20.06.2023, kandidati {...} me anë të komunikimit elektronik ka paraqitur kërkesën për tërheqjen nga kandidimi për procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin e lirë nr. 24, datë 18.01.2023, në fushën e të drejtës civile, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, protokolluar në Këshill me aktin {...}, datë 20.06.2023. Konkretisht ai shkruan se: Unë i nënshkruari {...}, me cilësinë e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, shpreh vullnetin tim të lirë, duke u tërhequr nga procedurat për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për pozicionin e lirë të shpallur përkatësisht me nr. 24, datë 18.01.2023, duke vijuar vetëm përzgjedhja për lëvizjet e tjera paralele dhe ngritjes në detyrë për të cilat kam kandiduar.

Në kushtet kur kjo rrethanë është e parashikuar në aktin normativ të Këshillit nr. 320, datë 17.09.2020, si një nga mundësitë për ta përmbyllur këtë procedurë, nga ana e relatorit është përgatitur ky draft, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.24, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

*Naureda Llagami*: Faleminderit!

Nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

*Illir Rusi*: Dakord.

*Irena Plaku*: Pro.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Ridvan Hado*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, projekt-akti miratohet sipas propozimit të relatorit.

\* \* \*

(Pika 6 të rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 27.06.2023)*

***Pika 7 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtim i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 14, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:57 dhe mbaroi në orën 13:32.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

9. *Marçela Shehu* (anëtare)  
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)  
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *Sarmela Titka, Përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
6. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI).*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
8. *BIRN.*

#### **RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtim i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 14, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek projekt-akti tjetër që edhe ky ka të bëjë me përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për z. {...} në një nga pozicionet atë të shpallur me vendim nr. 14. Për më shumë detaje, zoti Hallunaj.

*Dritan Hallunaj:* Nga ana e Këshillit, me vendimet nr.11 – nr.24 është vendosur hapjen e katërbëdhjetë procedura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë,

ndër të cilat për pozicionin e lirë nr. 14 ka kandiduar edhe gjyqtari z. {...}, aktualisht i transferuar përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas vendimit nr. 92, datë 06.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pasi është bërë me dije magjistratit dhe është verifikuar që në listën e paraqitur kishte kandiduar edhe për tre procedura për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, mbas këtij komunikimi zoti {...} ka përcjellë elektronikisht në Këshill zgjedhjen e tij për kandidim për lëvizjen paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 14/2023, kandidimin për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm në pozicionet e lira të shpallura nga Këshilli si dhe kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë në një nga pozicionet e lira të shpallura nga Këshilli.

Në vijim të procedurave, pasi janë bërë verifikime e para – duke mos u futur shumë në detaje – më datë 13.06.2023 kandidati z. {...}, përmes komunikimit elektronik, ka paraqitur kërkesën për tërheqjen nga kandidimi për procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin e lirë nr. 14, datë 18.01.2023, në fushën e të drejtës civile, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, protokolluar në Këshill me aktin nr. {...} prot., datë 15.06.2023, duke parashtruar se: ...“ju njoftoj se tërhiqem nga kandidimi në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 14, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Në këto kushte, meqenëse procedura e ndjekur e verifikimit është e plotë dhe duke pasur parasysh edhe kërkesën e tij për t’u tërhequr, relatori ia ka parashtruar KZHK-së dhe ky Komision në mbledhjen e datës 20.06.2023 ka vendosur dërgimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vendosur përfundimin e kësaj procedure për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për kandidati z. {...} për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi. Bashkëlidhur është edhe kërkesa e tij (e-maili) për tërheqjen nga kandidimi. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Atëherë nëse s'keni diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit të relatorit.

\* \* \*

(Pika 7 të rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 27.06.2023)*

**Pika 8 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtim i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 12 datë 18.01.2023, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:57 dhe mbaroi në orën 13:32.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

9. *Marçela Shehu* (anëtare)  
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)  
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *Sarmela Titka, Përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
6. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI).*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
8. *BIRN.*

#### **RENDI I DITËS:**

8. Shqyrtim i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 12 datë 18.01.2023, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë edhe kjo me përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për kandidaten znj. {...}.

Për më shumë detaje fjalën ia japim zotit Kurushi.

*Klodian Kurushi:* Faleminderit zonja Kryetare!

Me Vendimin nr.11 – nr.24, datë 18.01.2013 Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosur hapjen e katërmbëdhjetë procedura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë Tiranë dhe Durrës. Brenda afatit të kandidimit për pozicionet e lira nr.12 dhe nr. 20 datë 18.01.2023 kandidoi edhe znj. {...}, në Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat (aktualisht gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat).

Mbas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për tre procedurat në proces, mbështetur në pikën 9, të vendimit 12/2023, dhe 20/2023 mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr.77, datë 13.02.2023, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe znj. {...}.

Në përfundim të procedurës së verifikimit e cila ka përfunduar, për znj. {...} në lidhje me tre kriteret formale, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, të kandidimit të saj për lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira të përmendura më lart, Këshilli, me Vendimin nr. 180, datë 25.04.2023, ka vendosur: Kualifikimin e kandidatës dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 12 dhe nr. 20 datë 18.01.2023.

Me vendim nr. 294, datë 30.05.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 136, në pikën 1, të nenit 147, nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”, ndër të tjera, vendosi caktimin si relator të procedurës së përzgjedhjes për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 11, nr. 12, nr. 13 dhe nr. 17, kryetarin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z. Kurushi.

Më datë 31.05.2023, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 75, Kreu VI, të Vendimit nr. 320/2020 të KLGJ-së, kandidatja është njoftuar për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për lëvizje paralele si dhe për caktimin e relatorit. Nuk paraqiti



kundërshtime ose kërkesa për përjashtimin e relatorit apo për ndonjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit.

Më shkresën nr. {...} prot., datë 19.06.2023, kandidatja ka parashtruar se: “...paraqes kërkesën time për heqjen dorë nga procedura e lëvizjes paralele pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 12 datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kjo kërkesë depozitohet për të patur mundësi për të aplikuar në procedura të tjera për ngritjen në detyrë... ”.

Shqyrtimi nga Komisioni:

Duke vlerësuar të rregullt procedurën e verifikimit të ndjekur për znj. {...}, kandidate për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 12 datë 18.01.2023 si dhe duke pasur parasysh kërkesën e saj për t’u tërhequr nga kandidimi për këtë pozicion, relatori i çështjes ia parashtrroi rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Në mbledhjen e datës 21.06.2023 Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke e konsideruar të rregullt procedurën e ndjekur për znj. {...}, si dhe po ashtu, vlerëson të qartë dhe të plotë vullnetin e shfaqur nga kandidatja për t’u tërhequr nga kandidimi për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 12 datë 18.01.2023. Kështu që më pas Komisioni i propozon Këshillit të shqyrtojë relacionin së bashku me projektvendimin në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe për të vendosur ky i fundit për përfundimin e kësaj procedure për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit nëse nuk keni ndonjë diskutim mbi të.

**Ilir Rusi:** Dakord.

*Irena Plaku*: Pro.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Ridvan Hado*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur nga relatori.

\* \* \*

(Pika 8 të rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 27.06.2023)*

**Pika 9 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan e Lezhë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 248, 249, 250, 251, 252, 253, 254, 255, 256, 257 dhe 258, datë 24.05.2023”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:57 dhe mbaroi në orën 13:32.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Irena Plaku** (anëtare)

6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *Sarmela Titka, Përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
6. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI).*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
8. *BIRN.*

#### **RENDI I DITËS:**

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan e Lezhë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 248, 249, 250, 251, 252, 253, 254, 255, 256, 257 dhe 258, datë 24.05.2023”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin e fundit për mbledhjen e fundit, që ka të bëjë me miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan e Lezhë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet përkatëse nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Për më shumë detaje, zonja Ukperaj.

**Brikena Ukperaj:** Faleminderit zonja Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimet nr. 248, 249, 250 dhe 251, datë 24.05.2023 ka hapur 4 (katër) procedura për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për 4 (katër) pozicione të lira të përhershme në fushën e së drejtës civile. Për të njëjtën gjykatë Këshilli me vendimet nr.252 dhe 253 të së njëjtës datë, ka hapur edhe 2 (dy) procedura për lëvizje paralele për 2 (dy) pozicione të lira të përhershme në fushën e së drejtës penale.

Në të njëjtën ditë, Këshilli, me vendimin nr. 254, datë 24.05.2023 ka hapur 1 (një) procedurë për lëvizje paralele për 1 (një) pozicion të lirë të përhershëm në fushën e së drejtës civile në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, dhe për të njëjtën gjykatë, me vendimin nr. 255 ka hapur edhe 1 (një) procedurë për lëvizje paralele për 1 (një) pozicion të lirë të përhershëm në fushën e së drejtës penale.

Ndërkohë që me vendimet nr. 256, 257 dhe 258, datë 24.05.2023 janë hapur dhe 3 (tre) procedura për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për 3 (tre) pozicione të lira të përhershme në fushën e së drejtës administrative.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit për secilin nga pozicionet e mësipërme, bazuar në dokumentacionin e administruar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe tashmë e kemi të publikuar edhe në faqen zyrtare të internetit të KLGJ-së, rezulton të kenë kandiduar gjyqtarët sipas tabelës së mëposhtme:

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 248 kanë kandiduar gjyqtarët {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë,

gjqytari {...}, gjyqtarja {...}. Për efekt të leximit nuk po i përmend gjykatat specifike ku ata janë të caktuar apo emëruar.

Për vendimin nr. 249 kanë kandiduar gjyqtarët {...}, {...}, {...}.

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 250, gjyqtarët {...}, {...}, {...}.

Për pozicionin nr. 251, gjyqtarët {...}, {...}, {...}.

Për pozicionin nr. 252, gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}.

Për pozicionin nr. 253, gjyqtarët {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Për pozicionet e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë: Për pozicionin nr. 254, gjyqtarët {...} dhe {...}. Të njëjtët gjyqtarë kanë aplikuar edhe për pozicionin 255.

Për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për të tre pozicionet 256, 257, 258 kanë kandiduar të pestë gjyqtarët: {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}. Të pestë këta gjyqtarë kanë kandiduar njëkohësisht për të tria pozicionet, pra 256, 257, 258.

Në zbatim të nenit 43 të Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe vendimit nr. 320, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, faza e parë e procedurës së lëvizjes paralele, për çdo pozicion të lirë të shpallur, fillon për gjyqtarët kandidatë që kanë apo mund të kenë dy vlerësime etike profesionale. Në rast se për pozicionin konkret nuk ka kandidatë të tillë, ata janë tërhequr nga kandidimi ose janë skualifikuar për mosplotësim kushtesh, procedura e lëvizjes paralele vazhdon për kandidatët që kanë ose mund të kenë një vlerësim, e në mungesë edhe të këtyre të fundit, vijon me kandidatët që nuk kanë asnjë vlerësim. Për të bërë të mundur në veçanti gjyqtarët që “mund të kenë 2 vlerësime, 1 vlerësim, ose nuk mund të kenë asnjë vlerësim”, në pikën 9 të çdo vendimi (248-258) hapje procedure lëvizje paralele, Këshilli ka parashikuar se: “Pas përfundimit të afatit të kandidimit sipas pikës 3 të këtij vendimi, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, Këshilli miraton me vendim listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, të atyre që kanë ose mund të kenë një vlerësim, si dhe të kandidatëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim”.

Bazuar sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, pasi verifikoi përvojën profesionale të secilit nga gjyqtarët kandidatë si

më sipër dhe ecurinë e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për secilin prej tyre, sipas Skemës së Re të Vlerësimit të Gjyqtarëve, vlerësime të mbaruara, atyre në proces të filluara ose që mund të fillonin sipas programit të vlerësimeve të miratuara nga Këshilli, si dhe bazuar në detyrimin e parashikuar në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” për fillimin e procedurës së vlerësimit të përsheptuar të detyruar për gjyqtarët që kanë aplikuar në rastin konkret për lëvizje paralele, vlerëson se:

- Mundësia e pasjes së dy apo të një vlerësimi, evidentohet referuar programeve të vlerësimeve të miratuara nga Këshilli, pjesë e të cilëve janë: gradimet; vlerësimet periodike 3-vjeçare si dhe vlerësimet e përsheptuara në rastet kur gjyqtarët kandidojnë për lëvizje paralele. Hapja e procedurave për lëvizje paralele nuk nënkupton dhe as kërkon sipas ligjit miratimin e programeve të posaçme të vlerësimit për të gjithë gjyqtarët kandidatë;

- Referuar neneve 43, 84 dhe 171 të Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe vendimit të KLGJ nr.320/2020 për gjyqtarët që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar dhe që gjatë kësaj periudhe kanë më shumë se 1 vit pune si gjyqtar (duke përjashtuar stazhin profesional të kryer në kuadër të SHM), vlerësim i parë konsiderohet ai i gradimit. Për këta gjyqtarë, për efekt të pasjes së dy vlerësimeve, vlerësimi i përsheptuar i detyruar për vitin kalendarik 2022, si vlerësim i dytë për efekt të procedurës së lëvizjes paralele, do të fillojë vetëm nëse ata nuk janë përfshirë në programet e vlerësimit periodik të miratuara nga Këshilli (vlerësimi 3-vjeçar 2017-2019; vlerësimi 3-vjeçar 2020-2022 ose vlerësim i përsheptuar vitit kalendarik 2021).

- Për gjyqtarët që e kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar dhe që gjatë kësaj periudhe kanë më pak se 1 vit pune si gjyqtar, vlerësim i parë konsiderohet ai periodik 3-vjeçar i filluar ose që mund të fillojë, sipas programeve të vlerësimeve të miratuara nga Këshilli. Për këta gjyqtarë vlerësimi i dytë do të konsiderohet ai i përsheptuar i detyruar për vitin kalendarik 2022. Por ky i fundit do të konsiderohet i mundshëm për t’u kryer vetëm në rastin kur kanë kaluar më shumë se 2 vjet nga vlerësimi i fundit, në këtë rast nga viti 2019.

- Për gjyqtarët që nuk e kanë kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar, por që nuk janë përfshirë në programin e vlerësimeve të miratuar nga Këshilli, gradimi nuk mund të realizohet, prandaj për këta gjyqtarë vlerësim i parë do të konsiderohet vlerësimi i fundit etik dhe profesional që ka qenë në fuqi përpara Ligjit për Statusin. Për këta gjyqtarë vlerësim i dytë do të konsiderohet vlerësimi i përshpejtuar i detyruar për vitin kalendarik 2022.

- Për gjyqtarët që nuk e kanë kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar dhe që nuk kanë asnjë vlerësim etik dhe profesional sipas rregullave që kanë qenë në fuqi përpara Ligjit për Statusin, por që janë përfshirë në programin e vlerësimeve të miratuar nga Këshilli, gradimi nuk mund të realizohet, prandaj vlerësimi i parë do të konsiderohet ai periodik, sipas programit të vlerësimeve për vitin 2021, që i përket periudhës së vlerësimit 2017-2019, ose ai sipas programit të vlerësimeve për vitin 2023, që i përket periudhës së vlerësimit 2020-2022. Për gjyqtarët e përfshirë në programin e vlerësimeve 2017-2019, vlerësim i dytë do të konsiderohet vlerësimi i përshpejtuar i detyruar për vitin kalendarik 2022, vlerësim që Këshilli ka marrë përsipër të kryejë në rastet kur kandidatët kandidojnë për lëvizje paralele. Por ky i fundit do të konsiderohet i mundshëm për t'u kryer vetëm në rastin kur kanë kaluar më shumë se 2 vjet nga vlerësimi i fundit, në këtë rast është viti 2019.

- Për gjyqtarët e emëruar nga KLGJ, për të cilët verifikimi i pasurisë e figurës është bërë prej tij, vlerësim i parë etik-profesional i mundshëm për t'u kryer, do të konsiderohet ai i parashikuar në programin e vlerësimit për vitin 2023.

Bazuar në kriteret e mësipërme, lidhur me vlerësimet e kryera e mundësinë e kryerjes së tyre sipas Skemës së Re të Vlerësimit të Gjyqtarëve, për secilin gjyqtar në veçanti, konkludohet si më poshtë:

1. Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, i emëruar gjyqtar në datën 20.10.2020, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi ky gjyqtar nuk ka plotësuar ende përvojën 3-vjeçare profesionale.

2. Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, i emëruar në datën 09.01.2020, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi ky gjyqtar e ka plotësuar përvojën 3-vjeçare profesionale në datë 09.01.2023 dhe



nuk është përfshirë në programin e vlerësimeve për vitin 2023 (ku janë përfshirë të gjithë gjyqtarët që kanë plotësuar periudhën 3-vjeçare në vitin 2022).

3. Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, e njëjta situatë me gjyqtarin {...}, kjo gjyqtare nuk ka plotësuar ende përvojën 3-vjeçare profesionale sepse është emëruar në datën 20.10.2020

4. Për gjyqtaren {...}, e njëjta situatë, nuk mund të ketë asnjë vlerësim është emëruar në datën 20.10.2020. Nuk ka 3 vjet përvojë profesionale.

5. Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, i emëruar gjyqtar në datën 19.07.2019, mund të ketë vetëm një vlerësim etik profesional, pasi gjyqtari ka 3 vjet përvojë profesionale, të plotësuar përgjatë vitit 2022. Ky gjyqtar është pjesë e programit të vlerësimit për vitin 2023 dhe për të ka filluar procedura e vlerësimit me vendimin 173/2023 të Këshillit.

6. Për gjyqtaren {...}, mund të ketë një vlerësim. Ajo është përfshirë në programin e vlerësimit për vitin 2023. E ka plotësuar përvojën profesionale përgjatë vitit 2022. Procedura e vlerësimit për të ka filluar dhe është në proces.

7. Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, nuk mund të ketë asnjë vlerësim. E ka plotësuar përvojën profesionale përgjatë vitit 2023 dhe nuk është përfshirë në programin e vlerësimeve për këtë vit.

8. Për gjyqtaren {...}, është emëruar në datën 20.10.2020, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi kjo gjyqtare nuk ka ende përvojën 3-vjeçare profesionale.

9. Për gjyqtaren {...} mund të ketë një vlerësim, pasi ajo është pjesë e programit të vlerësimit për vitin 2023 dhe përvojën trevjeçare e ka plotësuar përgjatë vitit 2022. Vlerësimi për këtë gjyqtare është në proces.

10. Për gjyqtaren {...}, e emëruar gjyqtare në datën 20.10.2020, nuk mund të ketë asnjë vlerësim pasi kjo gjyqtare nuk ka plotësuar ende përvojën 3-vjeçare profesionale.

11. Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, i emëruar gjyqtar në datën 02.02.1991, gradimi si vlerësim i parë për periudhën e vlerësimit 2013-2016 nuk mund të realizohet, pasi ky gjyqtar nuk e ka

kaluar ende procesin e rivlerësimit kalimtar. Vlerësimi i parë etik-profesional për të sipas dispozitave kalimtare të vendimit nr.320/2020 “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjeve paralele”, është vlerësimi i fundit në kohë sipas dispozitave para hyrjes në fuqi të Ligjit “Për Statusin” i miratuar me vendimin nr. 47/8, datë 02.10.2017 të ish-KLD-së në nivelin “Mirë”. Për këtë gjyqtar vlerësim i dytë do të konsiderohet vlerësimi i përshpejtuar i detyruar për periudhën e vlerësimit që përkon me vitin kalendarik 2022.

12 dhe 13. Për gjyqtarin {...}, njëkohësisht edhe për gjyqtaren {...}, sepse ndodhen në të njëjtën situatë, të dy gjyqtarë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, por të transferuar për kohësisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, dhe që pas datës 01.07.2023 do të jenë gjyqtarë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje, të emëruar gjyqtarë në datën 09.01.2020, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, për shkak se përvojën profesionale 3-vjeçare e kanë plotësuar përgjatë vitit 2023 dhe nuk janë përfshirë në programin e vlerësimeve për vitin 2023.

14. Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, por pas datës 01.07.2023 gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje, i emëruar gjyqtar në datën 24.11.1993, mund të ketë dy vlerësime etike-profesionale. Vlerësimi i parë është ai i gradimit, në kushtet kur gjyqtari ka kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë, vlerësim i filluar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr.239, datë 30.06.2022 dhe është në proces. Për këtë gjyqtar duhet të fillojë vlerësimi i përshpejtuar për periudhën që përkon me vitin kalendarik 2022.

15. Për gjyqtaren {...}, e emëruar gjyqtare në datën 09.01.2020, aktualisht e komanduar ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi kjo gjyqtare e ka plotësuar përvojën profesionale në datën 09.01.2023 dhe nuk është përfshirë në programin e vlerësimeve për vitin 2023.

16. Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Kjo gjyqtare është emëruar në datën 20.10.2020, dhe nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi ajo nuk e ka plotësuar ende përvojën 3-vjeçare profesionale. Kjo gjyqtare është komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 249, datë 09.06.2021 për një afat deri në trevjeçar. Me vendimin nr.253, datë 07.07.2022 është

bërë ndryshimi i pozicionit të komandimit për këtë gjyqtare, nga ai i “Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë”, në pozicionin e ri të “Këshilltarit Ligjor në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme”. Referuar nenit 6 të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor 159/2023 periudha e vlerësimit të gjyqtarit të komanduar në Këshill është e njëjtë me periudhën e komandimit dhe si rregull gjyqtari i komanduar vlerësohet pas përfundimit të periudhës së komandimit. Në rastin konkret kjo gjyqtare ka kandiduar gjatë komandimit (pra nuk e ka përfunduar periudhën e komandimit) dhe në përputhje me parashikimet e pikës 3 të këtij neni, vlerësimi për të, për periudhën e komandimit deri në momentin e kandidimit, do të fillonte vetëm nëse kishin kaluar më shumë se dy vjet nga vlerësimi i fundit etik e profesional. Në kushtet kur gjyqtarja nuk ka plotësuar ende përvojën e saj 3-vjeçare profesionale për të pasur një vlerësim, asaj nuk mund t’i fillojë as vlerësimi tjetër për periudhën e komandimit deri në momentin e kandidimit.

Për sa më sipër, në pikën 1 të projektvendimit është parashikuar miratimi nga Këshilli i listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan e Lezhë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.248, 249, 250, 251, 252, 253, 254, 255, 256, 257 dhe 258 datë 24.05.2023, sipas Shtojcës I bashkëngjitur këtij vendimi, e cila përmban:

Listën e gjyqtarëve që kanë 2 (dy) vlerësime: Asnjë (zero) gjyqtar.

Listën e gjyqtarëve që mund të kenë 2 (dy) vlerësime:

1. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër

2. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, pas datës 01.07.2023, gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

Në pikën 2 të projektvendimit është parashikuar miratimi nga Këshilli i listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim:

Në listën e gjyqtarëve që kanë 1 (një) vlerësim: Asnjë (zero) gjyqtar.

Në listën e gjyqtarëve që mund të kenë 1 (një) vlerësim:

1. Znj. {...};
2. Znj. {...};
3. Z. {...};

Në pikën 3 të projektvendimit është parashikuar miratimi nga Këshilli i listës së gjyqtarëve që nuk mund të kenë asnjë vlerësim për efekt të pozicioneve të shpallura dhe ata janë: z. {...}; z. {...}; znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}; z. {...}; znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}.

Në projektvendim parashikohet dhe hyrja e tij në fuqi duke qenë se jemi para një akti me natyrë kolektive, ai hyn në fuqi me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit zonja Ukperaj!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime kalojmë në votimin e projekt-aktit.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord. (*Vota e zotit Hado nuk dëgjohet në audio, por i kontaktuar nëpërmjet e-mailit ka konfirmuar (citoj): “Vota ime është pro!”.* Për efekt të procesverbalit e-maili i konfirmimit të votës i bashkëlidhet procesverbalit të siglosur.)

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, projekt-akti miratohet sipas propozimit të sjellë nga relatorja.

Me kaq po e mbylлим mbledhjen e sotshme.

Faleminderit punë të mbarë.

\* \* \*

(Pika 9 të rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**